Vendim nr. 287, datë 15.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 15.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (G) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GAZMIR ZENELI,** përfaqësuar nga avokati Neshet Ngucaj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-132, datë 30.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gazmir Zeneli është duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm, të dhënë me vendim gjyqësor të formës së prerë ndaj personit të identifikuar në procesin penal si Fatmir Zeneli. Në lidhje me këtë dënim, krahas procesit penal të themelit, janë zhvilluar edhe disa procese të tjera gjyqësore mbi kërkesat e kërkuesit.

Procesi penal i themelit

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka proceduar penalisht shtetasin Fatmir Zeneli. Hetimet ndaj tij janë zhvilluar në mungesë dhe, në përfundim të tyre, çështja është dërguar për gjykim për akuzat e kryerjes së veprave penale "Vrasja me paramendim për motive të dobëta" të shtetasit L.H., "Vrasja me dashje" të shtetasit A.C., "Vrasja e mbetur në tentativë" në dëm të shtetasit D.P. dhe "Armëmbajtja pa leje".

3. Në përfundim të gjykimit, të zhvilluar në mungesë të të pandehurit, me pjesëmarrjen e mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 118, datë 19.07.2000, ka deklaruar fajtor shtetasin Fatmir Zeneli për veprat penale "Vrasja me paramendim" të shtetasit L.H., sipas figurës bazë të parashikuar në nenin 78 të Kodit Penal *(KP),* "Vrasja me dashje" të shtetasit A.C., "Plagosja e rëndë me dashje" të shtetasit D.P. dhe "Armëmbajtja pa leje", duke e dënuar atë, përkatësisht, me 25 vjet burgim, në bazë të nenit 78 të KP-së, me 20 vjet burgim, në bazë të nenit 76 të KP-së, me 10 vjet burgim, në bazë të nenit 88, paragrafi i parë, të KP-së dhe me 2 vjet burgim, në bazë të nenit 278, paragrafi i dytë, të KP-së. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të KP-së, ai është dënuar përfundimisht me 25 vjet burgim.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 148, datë 26.09.2000, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket vrasjes së shtetasit L.H., duke e deklaruar fajtor shtetasin Fatmir Zeneli për veprën penale "Vrasja me paramendim në rrethana rënduese", sipas figurës së cilësuar të parashikuar në nenin 78 të KP-së, dhe duke e dënuar me burgim të përjetshëm. Për pjesën tjetër, që lidhet me vrasjen e shtetasit A.C., plagosjen e shtetasit D.P. dhe armëmbajtjen pa leje, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi. Përfundimisht, në bazë të nenit 55 të KP-së, gjykata e apelit e ka dënuar të pandehurin me burgim të përjetshëm. Edhe gjykimi në apel është zhvilluar në mungesë të të pandehurit, me pjesëmarrjen e mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët, i cili ka paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 26, datë 17.01.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 30.03.2015 kërkuesi është arrestuar në Greqi, me qëllim ekstradimin në Shqipëri për ekzekutimin e vendimit penal të dënimit të sipërpërmendur, ndërsa në datën 17.08.2015 ai është ekstraduar dhe u është dorëzuar autoriteteve shqiptare.

7. Pas ekstradimit, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në procesin penal të themelit. Me vendimin nr. 40, datë 06.07.2016 (*vendimi nr. 40/2016*), Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për zhvillimin e gjykimit në mungesë, Gjykata ka vlerësuar se autoritetet kanë respektuar procedurat e njoftimit dhe se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal të zhvilluar ndaj tij, por ishte larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur të mos merrte pjesë në gjykimin e çështjes, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë. Për rrjedhojë, Gjykata e ka gjetur të pabazuar pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të gjykimit në mungesë, përfshirë të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve e të kontradiktoritetit. Gjykata, gjithashtu, ka vlerësuar të pabazuar edhe pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Procesi për kërkesën për lirim nga burgu

8. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për lirim nga burgu, në bazë të nenit 472 të KPP-së, duke pretenduar ekzistencën e një gabimi në identitet, pasi, sipas tij, nuk ishte personi ndaj të cilit ishte dhënë vendimi penal i dënimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 9, datë 30.01.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Pas verifikimeve të bëra për identitetin e personit të dënuar me vendimin nr. 118, datë 19.07.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk rezultonte e provuar që shtetasi Fatmir Zeneli të ishte person tjetër, i ndryshëm nga kërkuesi Gazmir Zeneli dhe se të dhënat për gjeneralitet e këtij të fundit ishin të sakta. Për rrjedhojë, gjykata ka arritur në përfundimin se kërkuesi ishte personi ndaj të cilit ishte dhënë vendimi penal i dënimit. Për sa u përket pretendimeve që lidheshin me respektimin e të drejtave procedurale gjatë gjykimit në mungesë në procesin penal të themelit, gjykata ka vlerësuar se ato tejkalonin kufijtë e atij gjykimi, ndërkohë që kërkuesi kishte në dispozicion mjete të tjera juridike, përfshirë kërkesën për rishikim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë,

me vendimin nr. 396, datë 05.06.2018, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1125, datë 16.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

9. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë për kundërshtimin e këtij procesi gjyqësor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 289, datë 27.11.2024 (*vendimi nr. 289/2024*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në vlerësimin e Kolegjit, pretendimet e kërkuesit ishin haptazi të pabazuara, pasi vendimet gjyqësore nuk rezultonin të ishin alogjike ose kontradiktore dhe të mos kishin pasqyruar argumente të mjaftueshme në mbështetje të përfundimeve të tyre. Sipas Kolegjit, gjykatat e faktit kishin analizuar rrethanat e çështjes dhe provat e shqyrtuara, duke arritur në përfundimin se kërkuesi Gazmir Zeneli ishte i njëjti person me të dënuarin Fatmir Zeneli. Në mbështetje të këtij vlerësimi, Kolegji i është referuar edhe vendimit nr. 40/2016, në të cilin Gjykata kishte vënë në dukje se kërkuesi njihej me të dy emrat, Fatmir dhe Gazmir Zeneli.

Procesi i parë për kërkesën për rishikimin e vendimit penal të dënimit

10. Pas përfundimit të shqyrtimit në apel të kërkesës për lirim nga burgu, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit penal të dënimit, në bazë të nenit 450, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", të KPP-së, duke pretenduar se nuk ishte i njëjti person me shtetasin e dënuar Fatmir Zeneli. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2218, datë 31.12.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Ajo ka arsyetuar se gjatë procesin penal të themelit ishte provuar se shtetasi Fatmir Zeneli ka vrarë shtetasin L.H., pasi ky i fundit i kishte vrarë vëllain M.Z. dhe kishte dalë nga burgu gjatë trazirave të vitit 1997, duke përshkruar edhe mekanizmin e ngjarjes. Sipas gjykatës, pretendimet e kërkuesit nuk gjenin mbështetje në asnjërin prej rasteve të rishikimit të parashikuara në nenin 450 të KPP-së, ndërsa për gabimin në identitet ligji parashikon mjete të posaçme në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, përfshirë edhe rastin kur gabimi lidhej vetëm me emrin. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 158, datë 12.03.2019, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1826, datë 07.11.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Procesi i dytë për kërkesën për rishikimin e vendimit penal të dënimit

11. Ndërkohë që rekursi në procesin e parë të kërkesës për rishikim ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, në datën 08.07.2019 kërkuesi ka paraqitur një kërkesë tjetër për rishikimin e

vendimit penal të dënimit, këtë herë në bazë të nenit 450, pika 1, shkronja "e", të KPP-së, duke pretenduar se vendimi penal i dënimit ishte dhënë ndaj shtetasit Fatmir Zeneli, ndërsa ai po vuante një dënim që nuk ishte dhënë ndaj tij. Sipas kërkuesit, megjithëse pas ekstradimit në Shqipëri u ishte drejtuar institucioneve të ndryshme, ai vijonte të vuante dënimin e një personi tjetër. Në këtë drejtim, kërkuesi ka kundërshtuar si të padrejta përfundimet e gjykatave në procesin gjyqësor për lirimin nga burgu dhe në procesin e parë të kërkesës për rishikim. Megjithatë, sipas tij, për sa kohë gjykatat kishin arritur në përfundimin se ai ishte i njëjti person me të dënuarin Fatmir Zeneli, atij i lindte e drejta për të kërkuar rishikimin e vendimit penal të dënimit, për shkak se gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të tij. Sipas kërkuesit, gjatë hetimeve paraprake ishte nxjerrë vendim për mosgjetjen e personit të akuzuar Fatmir Zeneli, ndërkohë që nuk ishte kryer asnjë kërkim për Gazmir Zenelin, çka, sipas tij, e bënte të detyrueshëm rishikimin e vendimit, me qëllim që të kishte mundësi të ballafaqohej me akuzën në një proces gjyqësor të zhvilluar në praninë e tij. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimi penal i dënimit ishte mbështetur vetëm në deklarimet e dhëna gjatë hetimit nga një dëshmitar, pa u paraqitur në gjykim ndonjë dëshmitar okular, për rrjedhojë, pa u mbështetur në ndonjë provë të drejtpërdrejtë të marrë në seancë gjyqësore. Sipas tij, pranimi i kërkesës për rishikim do të mundësonte thirrjen dhe pyetjen si dëshmitarë të shtetasve A.B. dhe B.V., të cilët, ndonëse sipas akuzës kishin qenë në shoqërinë e viktimës, nuk ishin pyetur as gjatë hetimeve, as në gjykim. Këta shtetas, sipas kërkuesit, kishin lëshuar deklarata noteriale, në të cilat kishin shprehur vullnetin për të dëshmuar.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1389, datë 31.07.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim, duke vlerësuar se nuk përmbushej asnjëri prej rasteve të parashikuara nga neni 450 i KPP-së. Sipas gjykatës, kërkuesi nuk pretendonte që faktet e vëna në themel të vendimit penal të dënimit të ishin të papajtueshme me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë. Po kështu, kërkuesi nuk kishte provuar që vendimi penal i dënimit ishte bazuar në një vendim të gjykatës civile ose administrative, i cili të ishte revokuar më pas, apo se pas dhënies së tij të kishin dalë ose të ishin zbuluar prova të reja, të cilat, vetëm ose së bashku me ato që ishin vlerësuar një herë, të tregonin se vendimi ishte i gabuar. Sipas gjykatës, nuk ishte provuar as që vendimi penal i dënimit të ishte dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose e një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale. Gjithashtu, kërkuesi nuk pretendonte ekzistencën e një vendimi të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), që ta bënte të domosdoshëm rigjykimin e çështjes. Së fundi, gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk kishte provuar se ishte gjykuar

në mungesë sipas nenit 352 të KPP-së, ndërkohë që vendimi penal i dënimit ishte dhënë ndaj shtetasit Fatmir Zeneli dhe jo ndaj Gazmir Zenelit, gjeneralitetet e të cilëve ishin të ndryshme. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

13. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 579, datë 17.10.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, pretendimet e kërkuesit kishin të bënin me ndryshimin ndërmjet identitetit të personit që vuante dënimin dhe atij ndaj të cilit ishte dhënë vendimi penal i dënimit. Këto pretendime, sipas saj, gjenin rregullim të posaçëm në nenin 472 të KPP-së, sipas të cilit gjykata e fazës së ekzekutimit, kur verifikon identitetin e personit të arrestuar dhe konstaton se ai nuk është personi ndaj të cilit duhet të ekzekutohet vendimi, urdhëron lirimin e tij. Gjykata e apelit ka arsyetuar se në rastin konkret nuk pretendohej që vendimi gjyqësor të kishte pasqyruar gabimisht një identitet të ndryshëm të personit të dënuar nga ai i personit që kishte kryer veprën penale, në kuptim të nenit 473 të KPP-së, por se ishte arrestuar gabimisht një person tjetër nga ai i dënuar. Ky pretendim, sipas gjykatës së apelit, ishte zgjidhur më parë me vendime të formës prerë të po asaj gjykate, konkretisht me vendimin nr. 396, datë 05.06.2018 (në procesin për kërkesën për lirim nga burgu) dhe vendimin nr. 158, datë 12.03.2019 (në procesin e parë të kërkesës për rishikim), në të cilat ishte arritur në përfundimin se bëhej fjalë për të njëjtin person. Për sa i përket pretendimit për provat e reja, në kuptim të nenit 450, pika 1, shkronja "c", të KPP-së, që lidhej me marrjen e deklarimeve të shtetasve A.B. dhe B.V., gjykata e apelit ka vlerësuar se, edhe pse ky ishte paraqitur si shkak rishikimi, por jo si shkak kryesor, kërkuesi synonte, në thelb, të provonte se nuk ishte i njëjti person me të dënuarin. Në veçanti, ajo ka evidentuar se deklarata noteriale e shtetasit B.V. ishte paraqitur për herë të parë në ankim dhe se, për më tepër, kjo deklaratë kishte qenë objekt diskutimi edhe gjatë shqyrtimit në apel të kërkesës së parë për rishikim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-132, datë 30.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit kishte analizuar në mënyrë tërësore dhe objektive provat e administruara në fashikullin gjyqësor dhe kishte dhënë arsyet ligjore përse kërkesa për rishikim nuk mund të pranohej. Ai kolegj ka evidentuar se kërkuesi ishte ekstraduar në vitin 2015 dhe shumë kohë më pas, në vitin 2019, kishte paraqitur kërkesën për rishikim, duke pretenduar se nuk ishte i njëjti person me të dënuarin. Sipas Kolegjit Penal, pretendimi për gabimin në identitet ishte shqyrtuar dhe zgjidhur më parë me vendime gjyqësore të

formës së prerë, në kuadër të kërkesës për lirim nga burgu dhe të kërkesës së parë për rishikimin e vendimit penal të dënimit. Për sa u përket provave të reja, Kolegji Penal ka vlerësuar se, megjithëse kërkuesi kishte ngritur indirekt edhe këtë shkak rishikimi, në thelb, ai synonte të provonte se nuk ishte i njëjti person me të dënuarin. Për më tepër, sipas Kolegjit Penal, deklaratat e shtetasve A.B. dhe B.V. nuk përbënin prova të marra në formën e kërkuar nga neni 149 i KPP-së, referuar edhe vendimit unifikues nr. 6, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndaj nuk mund të përdoreshin për të mbështetur shkakun e rishikimit sipas nenit 450, pika 1, shkronja "c", të KPP-së. Kolegji Penal ka konstatuar se vendimet e gjykatave të faktit ishin të arsyetuara dhe u kishin dhënë përgjigje si pretendimit të kërkuesit për gabim në identitet, ashtu edhe shkaqeve të tjera të parashtruara për rishikim. Për pretendimet që lidheshin me vlerësimin e provave dhe provueshmërinë e përgjegjësisë penale në procesin penal të themelit, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato nuk mund të bëheshin objekt shqyrtimi në atë proces, për sa kohë vendimi penal i dënimit kishte marrë formë të prerë.

15. Në datën 10.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në procesin e dytë të kërkesës për rishikimin e vendimit penal të dënimit. Ky ankim, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 03.06.2026.

16. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

17. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

17.1. Vendimet e gjykatave për rrëzimin e kërkesave në proceset gjyqësore të vëna në lëvizje prej tij janë mbështetur në arsyetime kontradiktore dhe të pabazuara, megjithëse dokumentet e gjendjes civile vërtetojnë se shtetasit Gazmir Zeneli dhe Fatmir Zeneli nuk janë i njëjti person, por kanë gjeneralitete të ndryshme, përkatësisht emrin, emrin e nënës dhe datëlindjen. Gjykatat kanë arritur gabimisht në përfundimin se bëhet fjalë për të njëjtin person, pa argumentuar me prova lidhjen

ndërmjet kërkuesit dhe shtetasit Fatmir Zeneli, të njohur me emrin "Fufa", duke u mbështetur në të dhëna të paprovuara.

17.2. Kërkuesi, i cili po vuan dënimin e dhënë ndaj shtetasit Fatmir Zeneli, është vënë në dijeni të vendimit penal të dënimit vetëm në datën 30.03.2015, kur është ndaluar në Greqi, pas rreth 16 vjetësh qëndrimi në emigracion me familjen. Pas ekstradimit ai u është drejtuar organeve të prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë, duke i informuar se po mbahej në burg për ekzekutimin e një vendimi penal të dhënë ndaj një personi tjetër, me të cilin nuk kishte asnjë lidhje.

17.3. Procedimi penal i vitit 1997 ka filluar ndaj shtetasit Fatmir Zeneli, por organi i prokurorisë nuk ka zbatuar rregullat procedurale për identifikimin e personit që akuzohej, duke kërkuar në regjistrat e gjendjes civile certifikatën dhe, më pas, duke u siguruar se nuk ka ndryshuar gjeneralitetet. Në aktet e dosjes hetimore nuk ka një certifikatë që të lidhë Gazmir Zenelin me Fatmir Zenelin, me pasojë dënimin e një personi që nuk ekziston sipas dokumenteve të gjendjes civile. As gjykatat nuk kanë verifikuar identitetin e personit të akuzuar, duke dhënë vendim ndaj një personi që nuk ekziston. Për pasojë, ekstradimi dhe ekzekutimi i vendimit penal të dënimit ndaj kërkuesit kanë qenë arbitrarë, në kundërshtim edhe me nenin 504 të KPP-së.

17.4. Në kushtet kur gjykatat kanë pranuar se shtetasit Gazmir Zeneli dhe Fatmir Zeneli kanë gjeneralitete të ndryshme, kërkuesit i lind e drejta për të kërkuar rishikimin e vendimit penal të dënimit. Kërkuesi po vuan dënimin me burgim të përjetshëm pa qenë personi ndaj të cilit është dhënë vendimi dhe, njëkohësisht, pa pasur mundësi të ballafaqohet me akuzën në një proces gjyqësor të zhvilluar në praninë e tij, në cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

18. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

19. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera.

20. Një prej rregullimeve të veçanta, si kriter paraprak, përcaktohet nga neni 31/a, pika 2, shkronja "dh", i Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Zbatimi i këtij parashikimi kërkon vlerësimin e përmbajtjes dhe të thelbit kushtetues të pretendimeve të ngritura, me qëllim përcaktimin nëse ato synojnë të rivënë në diskutim çështje të shqyrtuara dhe të zgjidhura më parë nga Gjykata. Në këtë vlerësim merr rëndësi edhe verifikimi nëse kërkesa mbështetet në fakte, rrethana ose argumente të reja me rëndësi kushtetuese, të cilat nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit të mëparshëm.

21. Në rastin konkret, Kolegji, duke analizuar pretendimet e kërkuesit dhe argumentet në mbështetje të tyre, vëren se ato lidhen, në thelb, me dy çështje: *së pari*, se kërkuesi nuk është i njëjti person me shtetasin Fatmir Zeneli, ndaj të cilit është dhënë vendimi penal i dënimit, dhe se, për rrjedhojë, po vuan dënimin e dhënë ndaj një personi tjetër; *së dyti*, se, për shkak se gjykimi penal i themelit është zhvilluar në mungesën e tij, kërkuesit duhet t'i njihet e drejta për rishikimin e vendimit penal të dënimit, me qëllim që të ballafaqohet me akuzën në një proces gjyqësor të zhvilluar në praninë e tij. Kolegji konstaton se këto dy çështje janë trajtuar edhe në vendimmarrjet e mëparshme të Gjykatës (*shih paragrafët 7 dhe 9 të vendimit*). Edhe pse ato vendimmarrje u përkasin proceseve të ndryshme gjyqësore, që kanë pasur për objekt, përkatësisht, kundërshtimin e vendimeve të dhëna në procesin penal të themelit dhe të vendimeve të dhëna për kërkesën për

lirim nga burgu, pretendimet kushtetuese të paraqitura në këto procese lidhen, në thelb, me të njëjtat çështje që ngrihen edhe në ankimin kushtetues në shqyrtim.

22. Konkretisht, për sa i përket pretendimit për gabimin në identitet, Kolegji vëren se ai është shqyrtuar më parë në kuadër të kontrollit kushtetues të vendimeve të dhëna për kërkesën për lirim nga burgu. Me vendimin nr. 289/2024, Kolegji i Gjykatës ka vlerësuar se gjykatat e zakonshme kishin arsyetuar përfundimin se shtetasit Gazmir Zeneli dhe Fatmir Zeneli ishin i njëjti person dhe se kërkuesi njihej me të dy këta emra, duke e gjetur haptazi të pabazuar pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në ankimin kushtetues individual në shqyrtim, kërkuesi përsërit të njëjtat argumente për dallimet e pretenduara ndërmjet të dhënave të tij të gjendjes civile dhe atyre me të cilat është identifikuar personi i dënuar Fatmir Zeneli, pa paraqitur fakte, rrethana ose argumente të reja me rëndësi kushtetuese që nuk janë shqyrtuar më parë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimi për gabimin në identitet synon, në thelb, rivënien në diskutim të një çështjeje kushtetuese për të cilën Gjykata është shprehur më parë.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë në procesin penal të themelit, Kolegji vëren se edhe kjo çështje është shqyrtuar më parë nga Gjykata në kuadër të ankimit kushtetues individual të kërkuesit kundër vendimeve të dhëna në atë proces. Në vendimin nr. 40/2016 Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e kërkuesit se nuk kishte marrë dijeni efektive për procesin penal të zhvilluar ndaj tij dhe se, për shkak të gjykimit në mungesë, i ishin cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjykata ka konstatuar se autoritetet kishin respektuar procedurat e njoftimit dhe se kërkuesi kishte pasur dijeni për procesin penal, por ishte larguar nga vendi me vullnet të lirë, duke zgjedhur të mos merrte pjesë në gjykim, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë. Për rrjedhojë, ajo e ka gjetur të pabazuar pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të gjykimit në mungesë, duke mbajtur në konsideratë nenin 33 të Kushtetutës, i cili, ndërsa në pikën 1 garanton të drejtën e individit për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet, në pikën 2 përjashton nga përfitimi i kësaj të drejte personin që i fshihet drejtësisë (*shih paragrafin 27 të vendimit nr. 40/2016*). Gjykata ka shqyrtuar, gjithashtu, prapësimin e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, për mosshterimin e mjeteve juridike nga kërkuesi. Duke iu referuar parimit të subsidiaritetit dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata ka vlerësuar se, në rastet e gjykimit në mungesë në të gjitha shkallët, ankimi kushtetues individual përbënte mjet juridik efektiv për verifikimin nëse autoritetet kishin respektuar rregullat

procedurale dhe kishin marrë masat e nevojshme për njoftimin e të pandehurit. Në të tilla raste, sipas Gjykatës, kërkuesit nuk i kërkohej shterimi i mjeteve të tjera ligjore, siç janë kërkesa për rishikim ose kërkesa për rivendosjen në afat. Në këto rrethana, Kolegji konstaton se pretendimi për parregullsinë e gjykimit në mungesë jo vetëm që është ngritur më parë nga kërkuesi, por është shqyrtuar në themel nga Gjykata, e cila e ka gjetur atë të pabazuar.

24. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se kërkesa e dytë për rishikimin e vendimit penal të dënimit është mbështetur në nenin 450, pika 1, shkronja "e", të KPP-së, dispozitë e shtuar me ligjin nr. 35/2017, pas dhënies së vendimit nr. 40/2016 të Gjykatës. Kjo dispozitë parashikon si shkak rishikimi gjykimin e personit në mungesë, sipas nenit 352 të KPP-së dhe kërkimin prej tij të rigjykimit të çështjes, duke përcaktuar një afat 30-ditor nga marrja dijeni. Megjithatë, Kolegji çmon se parashikimi i mëvonshëm i këtij shkaku rishikimi nuk përbën *per se* një element të ri me rëndësi kushtetuese që të përligjë rishqyrtimin e pretendimit për parregullsinë e gjykimit në mungesë, për të cilin Gjykata është shprehur më parë. Në rastin konkret, kërkuesi vijon ta mbështesë ankimin kushtetues në pretendimin se ai është gjykuar në mungesë, pa pasur dijeni për procesin penal dhe pa iu garantuar mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pa parashtruar ndonjë argument të ri me rëndësi kushtetuese, të dallueshëm nga ato të shqyrtuar më parë nga Gjykata. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi synon, në thelb, rivlerësimin e rregullsisë kushtetuese të gjykimit në mungesë, çështje për të cilën Gjykata është shprehur përfundimisht me vendimin e saj nr. 40/2016.

25. Për sa më sipër, për sa kohë që pretendimet e kërkuesit për gabimin në identitet ndërmjet tij dhe personit të dënuar Fatmir Zeneli, si dhe për parregullsinë e procesit penal për shkak të gjykimit në mungesë janë bërë objekt i vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës dhe janë gjetur të pabazuara, si dhe për sa kohë që kërkuesi nuk ka paraqitur fakte, rrethana ose argumente të reja me rëndësi kushtetuese që të përligjin rishqyrtimin e këtyre pretendimeve nga Gjykata, ato nuk mund të merren më në shqyrtim.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "dh", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.